

EDMOND MALAJ

LEZHA GJATË PERIUDHËS SË ANTIKITETIT

Hyrje

Lezha shtrihet në veriperëndim të Shqipërisë midis ultësirës së Shkodrës dhe Bregut të Mates. Vendndodhja e saj midis kryeqytetit të vendit, Tiranës (rreth 55 km larg) dhe qytetit më të madh verior, Shkodrës (rreth 35 km larg) e bëjnë atë sot një qendër të rëndësishme transite. Qyteti, i cili në pamje të parë duket i ri, është shumë i lashtë,



Fig 1. Mure të lashta të Lisit antik
Foto: Edmond Malaj 2015

madje edhe në periudhat prehistorike janë gjetur gjurmë banimi. Në Antikitet, Lezhën e quanin *Lissos* në periudhën helene, dhe *Lissus* në periudhën romake.

Sipër këtij qyteti qëndron kështjella, e cila ngrihet mbi një kodër shkëmbore të lartë 200 m me formë katërkëndëshe. Kjo kështjellë është shumë e vjetër. Lezha pra, është një ndër qytetet më të lashta të trojeve shqiptare

që ka mbijetuar dhe ka vazhdimësi deri në ditët tona. Nën të, pranë lumit Drin fillon e shtrihet qyteti, i cili sot është zmadhuar me lagje të reja dhe i ka kaluar shumë përmasat që ka pasur në gjysmën e shek. XX. Kjo shtrirje e qytetit ka ndodhur shumë shpejt sidomos në 30 vjetët e fundit.

Në këtë artikull do të bëhet fjalë për historinë e qytetit në Antikitet dhe do të përdoret kryesisht emri “Lisos”, për periudhën helene, dhe “Lissus” për periudhën romake. Për këto jam bazuar qoftë në të dhëna që munda të gjej tek autorë të ndryshëm, si të huaj ashtu edhe vendas, qoftë në punime arkeologjike, të cilat e plotësojnë kuadrin historik. Autorët, tek veprat e të cilëve përmendet Lezha, janë të shumtë por më poshtë po përmend vetëm disa prej tyre.

Të dhënat historike të para në lidhje me këtë qytet i kemi që në lashtësi dhe këtu mund të përmendet së pari historiani grek Polybi (rreth 200-120 para Kr.), i cili e përmend Lisusin në librin e tij të historive (*Historiae*)¹, më pas dhe nga historiografi grek Diodori i Sicilisë (shek. I para Kr.), i cili shkruan mbi Lisusin në veprën e tij madhështore “Biblioteca Historica”²; më tej Straboni (63 para Kr. – 20 pas Kr.) në “Gjeografia” (*Geographica*) L. VIII³, pastaj Tit Livi në veprën e tij “*Ab urbe condita*”⁴ etj. Këto vepra të Antikitetit janë të dorës së parë dhe ndër burimet kryesore për këtë artikull. Më tej, në fragmente të shkurtra e përmendin këtë qytet edhe Ptolemeu, Appianus dhe Hierokles.⁵

Të dhënat mbi Lissosin antik janë më të shpeshta sidomos nëpër punimet e shek. XIX, të cilat kanë si bazë kryesore Diodorin, Polybin dhe autorë të tjerë, të cilët i përmendëm më lart. Nga studiuesit e kësaj periudhe mund të përmend së pari historianin dhe arkeologun kroat Shime Ljubiç (Šime Ljubić)⁶; më tej Adolf Bauer⁷; Johannes Hahn⁸. Autor tjetër i shek. XIX është edhe Hekardi (Hecquard)⁹.

¹ Polybi, “*Historiae*”, në *Ilirët dhe Iliria tek autorët antikë*, përgatitur nga Selim Islami (redaktor përgjegjës), Frano Prendi, Hasan Ceka, Skënder Anamali, botim i katërt, Tiranë: Toena 2002, f. 61-62.

² Diodori, “*Bibliotheca Historica*”, në *Ilirët dhe Iliria ...*, f. 136-144.

³ Strabonis, “*Geographica*”, në *Ilirët dhe Iliria ...*, f. 149-164. Në lidhje me librin VIII, botimi që kemi në dispozicion jep prej tij vetëm disa fragmente, ku nuk përmenden ngjarjet në lidhje me Lisin dhe me pirustët. Shih edhe: Frano Prendi & Koço Zheku, “Qyteti ilir i Lisit. Origjina dhe sistemi i fortifikimit të tij”, në *Iliria*, nr. 2, Tiranë: 1972, f. 215.

⁴ Për citimin e burimeve në gjuhën origjinale latine do të përdoren edhe tekstet që ofrohen online nga: *The Latin Library*. URL: <http://www.thelatinlibrary.com> (11.11.2017); *Packard Humanities Institute, Canon of Latin Authors*: URL: <http://latin.packhum.org/canon> (11.11.2017); Packard Humanities Institute <http://inscriptions.packhum.org/allregions>

⁵ Ptolemei, “*Geographi*”; Appiani Alessandrini, “*Historia Romana (Illyrica)*”, në *Ilirët dhe Iliria...*, f. 264, 250.

⁶ *Österreichisches Biographisches Lexikon 1815-1915*. Hrsg. von der Österreichischen Akademie der Wissenschaften. Bd. 5. Wien: Österreichischen Akademie der Wissenschaften 1971, f. 255; Shih edhe: F. Prendi & K. Zheku, “Qyteti ilir i Lisit...”, në *Iliria ...*, nr. 2, f. 215.

⁷ Adolf Bauer, “Die Anfänge der österreichischen Geschichte, Griechischen Colonien in Dalmatien, Roms erster illyrischer Krieg”, në *Archaeologisch-epigraphische Mittheilungen Aus Oesterreich-Hungarn*. Hrsg. Von O. Bendorf und E. Bornemann. Jahrgang XVIII, Wien: Alfred Hölder 1895, f. 130.

Një rëndësi të veçantë kanë edhe gërmimet arkeologjike dhe hulumtimet historike, të cilat zënë fill që në fillim të shek. XX, prej një sërë arkeologësh dhe autorësh, të cilët japin të dhëna të rëndësishme për Lissos/Lissus-in antik. Ndër ta mund të përmendim së pari Degrandin (Jules Alexandre Théodore)¹⁰; më tej edhe Th. Ippen¹¹; E. Meyer-in¹², C. Prashniker dhe A. Schober¹³, Giuseppe Valentini me artikujt e tij të shumtë, në të cilat ka të dhëna të shumta edhe për Lissusin, qoftë për qytetin antik, qoftë për atë mesjetar¹⁴ etj. Edhe këta autorë të lartpërmendur bëjnë pjesë në literaturën që është përdorur për këtë artikull. Së fundi, mund të përmend këtu edhe arkeologët bashkëkohor gjermanofonë Erwin Pochmarski¹⁵ dhe Andreas Oettel¹⁶, të cilët kanë shkruar disa artikuj në lidhje me arkeologjinë dhe historinë e Lezhës antike.

⁸ *Albanesische Studien* von Dr. jur. Johann Georg von Hahn., K. K. Consul für das östliche Griechenland. Nebst einer Karte Nebst einer Karte und anderen artistischen Beilagen. [Erstes Heft]. Jena: Friedrich Mauke, 1854, f. 92-93.

⁹ Hyacinthe Hecquard, *Histoire et description de la Haute Albanie ou Guégarie*. Paris: Chez Arthus Bertrand (1858), f. 151. (Në shqip: Hyacinthe Hecquard, *Historia dhe përshkrimi i Shqipërisë së Epërme ose i Gegërisë*, përktheu nga frëngjishtja dhe pajisi me shënime Oriana Tamburi, Tiranë: Plejad 2008).

¹⁰ Jules Alexandre Théodore Degrande, *Souvenirs de la Haute-Albanie*. Par A. Degrand, Consul de France. Paris: H. Welter 1901, f. 176. (Versioni shqip: Aleksander Degrande, *Kujtime nga Shqipëria e Epërme*, përktheu nga frëngjishtja Vilda Sokoli, Shkodër: Phoenix, 2001).

¹¹ *Skutari und die Nordalbanische Küstenebene*. Von Theodor A. Ippen K. u. K. Österr-Ungar. Generalkonsul. Mit 24 Abbildungen. Sarajewo: Daniel A. Kojan 1907, f. 55-59.

¹² Eduard Meyer, *Geschichte des Altertums*. Fünfter Band, Zweite Auflage. Stuttgart / Berlin: Gotta 1913, f. 162, 163.

¹³ Camillo Praschniker / Arnold Schober, *Archäologische Forschungen in Albanien und Montenegro*, Wien: Alfred Hölder 1919 [= Akademie der Wissenschaften in Wien, Schriften der Balkankommission], f. 14.

¹⁴ Giuseppe Valentini, *Vepra III* (Publicistikë, studime dhe tekste), përgatitur nga Ksenofon Krisafi, Ndrëçim Kulla, Dritan Thomollari, Tiranë: Plejad, 2006, f. 232; Giuseppe Valentini, *Vepra I* (Publicistikë, studime dhe tekste), përgatitur nga Ksenofon Krisafi, Ndrëçim Kulla, Dritan Thomollari. Tiranë: Plejad, 2005, f. 442.

¹⁵ Erwin Pochmarski & Gëzim Hoxha, "Lissos: Quellen und Stadtgeschichte", në *Römisches Österreich*, 25/2005, f. 243-251.

¹⁶ Andreas Oettel, "Von der Illyrischen Festung zum römischen oppidum. Die Transformationsprozesse der Illyrischen Stadt Lissos/Lissus", në *Proceedings of the International Congress of Albanian Studies* (Tirana, 21-22 November 2013),

Krahas tyre ka edhe një numër tjetër autorësh shqiptarë, punimet e të cilëve, i kam përfshirë gjithashtu në këtë artikull. Këtu mund të përmendim shkurt emrat e tyre: Hasan Ceka¹⁷, Selim Islami¹⁸, S. Pulahën¹⁹, K. Kamsin²⁰, Z. Shkodrën²¹, F. Prendin²² e K. Zhekun²³ me artikujt e punimet e tyre dhe së fundi (last but not least) arkeologun bashkëkohor Gëzim Hoxha²⁴, punimet e të cilit na japin të dhëna të reja e saktësojnë edhe më tej duke rifreskuar informacionin arkeologjik dhe historik të Lezhës antike.

Zanafillat

Qyteti, nga helenët njihej me emrin *Lissos*, kurse romakët e quanin atë *Lissus*.²⁵ Emrin qyteti duhet ta ketë trashëguar nga një fis i vogël me

ed. by L. Përzhita, I. Gjipali, G. Hoxha, B. Muka, Qendra e Studimeve Albanologjike, Instituti i Arkeologjisë, Tiranë: 2014, f. 455-468, etj.

¹⁷ Hasan Ceka, *Probleme të Numismatikës Ilire*. Me një katalog të monetave të pabotueme apo të rralla të Ilirisë së Jugut, Tiranë: Universiteti Shtetëror i Tiranës, 1965.

¹⁸ Selim Islami, *Historia e Ilirëve. Përmbledhje punimesh*. Tiranë: Toena / Albanian Heritage 2008; Selim Islami, “Prerjet monetare të Shkodrës, Lisit dhe Gentit”, në *Iliria*, II, Tiranë: 1972, f. 351-376.

¹⁹ Selami Pulaha, “Vështrim mbi historinë e Lezhës”, në *Lissus*, Tiranë: Naim Frashëri, 1968, f. 83-117.

²⁰ Kolë Kamsi, “Lezhja”, në *Buletin shkencor i Institutit Pedagogjik të Shkodrës*, 1965, f. 305-308.

²¹ Shih edhe: F. Prendi & K. Zheku, “Qyteti ilir i Lisit...”, në *Iliria* ..., nr. 2, f. 215.

²² Frano Prendi, “Vazhdimësia etno-kulturore e Lisit në Mesjetë”, në *Lis 6*, përgatitur nga Muzeu Historik i Lezhës, Lezhë: Lisitan, 1993, f. 7-13; F. Prendi & K. Zheku, “Qyteti ilir i Lisit...”, në *Iliria*, nr. 2, Tiranë: 1972, f. 215-244.

²³ Koço Zheku, *Lisi në shekuj*, red. Jani Toçka, Tiranë: 8 Nëntori, 1988.

²⁴ Autori në fjalë (arkeolog në Institutin e Arkeologjisë pranë Akademisë së Studimeve Albanologjike) ka vite që merret me gjurmimet në Lissos/Lissus dhe ka një gamë të gjerë botimesh në lidhje me këtë qytet. Unë këtu po jap vetëm disa tituj të përzgjedhur të tij: Gëzim Hoxha, “Risi që lindin mbi petkun e së vjetrës: Dukuri metamorfoze në qytetin Lissus gjatë periudhës antike të vonë”, në *Iliria* XXXVIII/2014, Tiranë: 2015, f. 41-67; Gëzim Hoxha, “Die Transformationsprozesse in der Stadt Lissus während der Spätantike”, në *Proceedings of the International Congress of Albanian Studies* (Tirana, 21-22 November 2013) ..., f. 511-527; Erwin Pochmarks & Gëzim Hoxha, “Lissos: Quellen und Stadtgeschichte”, në *Römisches Österreich*, 25/2005, f. 243-251 etj.

²⁵ Konstantin Jireček, “Skutari und sein Gebiet im Mittelalter”, *Illyrisch-Albanische Forschungen*. Unter Mitwirkung von Professor Dr. Konstantin Jireček [e të tjerë].

emrin LISITAN (ΛΙΣΣΙΤΑΝ) i cili duhet të ketë jetuar në kohëra shumë të lashta në atë vend.²⁶ Kur u themelua Lisus? Kësaj pyetjeje nuk mund t'i japim as edhe sot një përgjigje përfundimtare. Sipas G. Valentinit, Lezha duhet të ketë pasur origjinë ilire, sepse ata e kishin zakon të ngrinin fortesa karakteristike (forcome), të cilat i ndërtonin mbi kodër në ultësirën e fundit.²⁷

Të këtij mendimi janë edhe arkeologët shqiptarë F. Prendi dhe K. Zheku, të cilët fazat e para të krijimit të Lisusit i lidhin me ilirët, të cilët në fillim ngritën muret e para të një vendbanimi prehistorik ilir në majën e Shelbuemit²⁸, dhe më vonë një vendbanim tjetër të fortifikuar, paraqytetar, në atë vend, ku ndodhet sot kështjella.²⁹ Karl Patsch³⁰ dhe Theodor Ippen në lidhje me ngulmimin e parë në këtë vend, thonë që si në Shkodër ashtu edhe në Lisus, të parët që u ngulën duhet të kenë qenë trakë,³¹ gjë që nuk gjen mbështetje tek studiuesit e tjerë.

Zheku në lidhje me krijimin e qytetit dallon tri faza³² nëpër të cilat është krijuar Lezha:

1. Faza e parë: Ngulmimi dhe krijimi i vendbanimit të hapur, të vendosur në terren fushor, i cili përfaqësonte një bashkësi territoriale;
2. Faza e dytë: Zgjedhje e një vendstrehimi të mbrojtur nga natyra si dhe fortifikimi i tij nga vetë ata që do ta përdornin atë në rast rreziku;
3. Faza e tretë: Ndërtimi i qendrës protourbane të vendosur në majë të kodrës dhe fortifikimi i saj me mure rrethuese.

Zusammengestellt von Dr. Ludwig von Thallóczy. I. Band. Mit einer Landkarte. München/Leipzig: Duncker und Humblot 1916, f. 123.

²⁶ K. Zheku, *Lisi në shekuj ...*, f. 19.

²⁷ G. Valentini, *Vepra III ...*, f. 232; shih edhe: G. Valentini, *Vepra I ...*, f. 442.

²⁸ F. Prendi & K. Zheku, "Qyteti ilir i Lisit...", në *Iliria ...*, nr. 2, f. 244; shish edhe: K. Zheku, *Lisi në shekuj ...*, f. 12.

²⁹ F. Prendi, "Vazhdimësia etno-kulturore ...", në *Lis 6 ...*, f. 7.

³⁰ Karl Patsch, "Thrakische Spuren an der Adria", në *Jahreshefte des Österreichischen Archäologischen Institutes in Wien*. Band X. Wien: Alfred Hölder 1907, f. 169-170.

³¹ Th. A. Ippen, *Skutari und die Nordalbanische ...*, f. 55.

³² K. Zheku, *Lisi në shekuj ...*, f. 13.




Fig. 2. Plani i Lisit

Burimi: C. Praschniker/ A. Schober, *Archäologische Forschungen ...*, f. 15.

Formën e plotë e të mirëfilltë të një qyteti, Lezha duhet ta ketë marrë në fund të shek. IV, e më pas, në kohën kur aty Dionizi i Sirakuzës vendos një koloni helene. Sipas Diodorit të Sicilisë, rreth vitit 385 para Krishtit Dionyzios Plaku, Tirani i Sirakuzës, themeloi në Lis një koloni greke³³, e cila duhej t’i shërbente atij si bazë për veprime të mëtejshme në Adriatik³⁴, për kontrollin e rrugëve detare për në Greqi,³⁵ si dhe për përhapjen e influencës helene në Pellgun e Adriatikut.³⁶

³³ Diodori, “Bibliotheca Historica”, në *Ilirët dhe Iliria ...*, f. 138.

³⁴ Pierre Cabanes & Oliver Chaline & Bernard Doumerc & Alain Ducellier & Michel Sivignon, *Historia e Adriatikut*, nën drejtimin e Pierre Cabanes, parathënie nga Jaques Le Goff, përktheu nga frëngjishtja Adrian Klosi, Arben Leskaj, Tiranë: SHLK, 2005, f. 58. Mbi themelimin e Lisit si koloni helene, nga Sirakuza shih edhe: Milan von Šufflay, *Städte und Burgen Albaniens hauptsächlich während des Mittelalters*. Vorgelegt in der Sitzung am 24. April 1918. Kommissions-Verleger der Akademie der Wissenschaften in Wien. Wien/Leipzig: Hölder-Pichler-Tempsky A.-G. 1924, f. 3, 9.

Nga Lezha, Dionyzios mbështeti Alketin, princin e Molosëve në Epir, i cili, i përzënë nga territoret e veta, kishte ardhur pikërisht këtu për të gjetur strehim.³⁷ Dionizios e pajisi Alketin me trupa ilire dhe i ndihmoi më tej që të kthehej në vendin e vet,³⁸ por kjo ndërmarrje nuk përfundoi pa luftë. Në fillim ushtria ilire nuk ndeshi në ndonjë kundërshtim dhe sipas Diodorit, trupat filluan të shkretinin vendin, por më pas ata hasën në molosë dhe aty u ndez një betejë e madhe, nga e cila ilirët dolën fitimtarë, duke vlarë në këtë betejë rreth 15.000 (pesëmbëdhjetë mijë) molosë.³⁹

Po nga Lisos, Dionizi nisi edhe komandantin e tij të këtij qyteti me trupa për të mbështetur farët helenë (banorët e qytetit Faros [sot Hvar në Kroaci]), të cilët në vitin 384 kishin themeluar një koloni në ishullin Faros (sot Lesina), ngaqë ishin sulmuar nga ilirët që jetonin në kontinent.⁴⁰



Fig. 3. Mure të lashta të Lisit, të periudhës së Antikitetit

Foto: Edmond Malaj 2012

Rreth kësaj ngjarjeje na informon përsëri Diodori. Sipas tij, banorët e vjetër, të cilët të spostuar nga helenët e ardhur, kishin ndërtuar një qytet tjetër të rrethuar me mure në një vend shumë të fortë të ishullit. Ata fillojnë t'i shikojnë të ardhurit helenë në Far (Faros) me sy të keq⁴¹ dhe thërrasin për ndihmë ilirët që banonin në kontinent në brigjet përballë

³⁵ Dankward Vollmer, *Symploke: das Übergreifen der römischen Expansion auf den griechischen Osten*. Untersuchungen zur Römischen Aussenpolitik am Ende des 3. Jahrhunderts v. Chr. Stuttgart: Franz Steiner 1990 [=Hermes. Zeitschrift für Klassische Philologie. Einzelschriften – Heft 54], f. 40

³⁶ Selami Pulaha, *Lezha - Vështrim historik-geografik*, përgatiti për botim Agim Parruca, Shkodër: Idromeno [pa vit botimi], f. 18.

³⁷ E. Mayer, *Geschichte des Altertums V ...*, f. 162.

³⁸ Diodori, "Bibliotheca Historica ...", në *Ilirët dhe Iliria ...*, f. 138.

³⁹ Po aty.

⁴⁰ E. Mayer, *Geschichte des Altertums V ...*, f. 162.

⁴¹ Diodori, "Bibliotheca Historica", *Ilirët dhe Iliria ...*, f. 138.

tyre. “Një numër i madh anijesh të vogla me më shumë se dhjetë mijë veta brenda zbritën në ishullin Far, shkatërruan pasuritë e helenëve dhe vranë shumë prej tyre.”⁴² Helenëve të Farit u erdhi në ndihmë sunduesi i Lisosit, i cili qe vendosur aty nga Dionizi. Humbja në anën e ilirëve qe e madhe, anijet e tyre u mbytën nga forcat e Dionizit dhe u derdh shumë gjak ilir që banonin në ato anë. Nga forcat ilire, sipas Diodorit, u vranë më tepër se pesë mijë dhe u zunë rob rreth dy mijë vetë.⁴³

Gjatë kësaj kohe duket se zë fill edhe një zmadhim i qytetit,⁴⁴ dhe mbi këtë zmadhim Farlati shkruan që Dionizi ndërtoi në qytet jo vetëm ndërtesa publike e gjimnaze, por edhe tempuj për perënditë, për të cilat Dionizi kujdesej t’i zbukuronte sa më shumë.⁴⁵ Megjithatë edhe këto të dhëna që burojnë kryesisht nga Diodori janë të paplota, pasi muret rrethuese të qytetit duhet të jenë ngritur para vitit 385, dhe duhet të kenë qenë punë e banorëve vendas ilir, të cilët u druheshin armiqve që vinin nga deti.⁴⁶ Pra, edhe historiani Cabanes, ashtu si Giuseppe Valentini është i mendimit që Lezha në origjinën e saj është ilire.

Valentini në lidhje me krijimin e kolonisë helene të Lisosit nga Dionizi, shpreh edhe një dyshim tjetër: “Rreth e qark nuk gjendet dhe nuk është gjendur asnjë monedhë e atyre kohërave, pra monedha me prejardhje sirakuziane.”⁴⁷ Megjithatë, K. Jireček, fazat e para të ekzistencës së Lisos-it si koloni sirakuziane nuk i vë në diskutim dhe shkruan që emri i kështjellës së njohur të kësaj kolonie sirakuzane ishte *Akrolissos*.⁴⁸

Në lidhje me muret, Hahn-i vëren aty themele të vjetra të mureve të kështjellës, të ndërtuara me blloqe shumë të mëdha shkëmbore, të tipit të

⁴² Po aty.

⁴³ Po aty.

⁴⁴ P. Cabanes, *Historia e Adriatikut...*, f. 58.

⁴⁵ *Illyrici Sacri. Tomus Septimus, Ecclesia Diocletiana, Antibarensis, Dyrrhachiensis et Sirmiensis, cum eorum suffraganeis*, auctore Daniele Farlato, Presbytero Societatis Jesu, et Jacobo Coletto olim ejusdem Societatis alumno. Venetiis, MDCCCXVII. Aput Sebastianum Coleti. Superiorem permissu ac privilegio. (Botim i dytë, Prishtinë: Arbi 2004), f. 384.

⁴⁶ P. Cabanes, *Historia e Adriatikut...*, f. 59.

⁴⁷ G. Valentini, *Vepra III...*, f. 233. Sipas Valentinit “E vërteta është që ndonjëri mund të verë në dyshim dhe jo pa argument bindës nëse kolonia dionisiane është Lisi jonë apo Lissa në Dalmaci.” *Po aty*, f. 232.

⁴⁸ K. Jireček, “Skutari und sein Gebiet ...”, f. 123.

“mureve ciklopike”⁴⁹, të cilat ishin të ngjashme me ato të Hellas.⁵⁰ Ky lokalitet përbëhej nga dy pjesë, nga Akrolisos që ishte kështjella dhe nga Lissos që ishte qyteti, të cilin Hahn gabimisht e përmend si vend bregdetar dhe që thotë se duhet të kërkohet në breg të detit dhe me këtë nënkupton Shën Gjinin (*St. Juan di Medua*).⁵¹

Pra, si përfundim mund të theksojmë edhe një herë që, duke marrë parasysh atë që u tha më lart, muret rrethuese i përkasin një periudhe më të hershme se viti 385. Themelimin e Lissosit duhet ta kërkojmë më përpara⁵² jo në fund të shek. IV para Krishtit.

Ekzistojnë edhe monedha të lisiotëve me mbishkrime greke⁵³, të cilat sipas G. Valentinit i përkasin periudhës së mëvonshme të Agatokleut, më tej monedha lokale dhe ndoshta që mund t’i përkisnin epokës së artit maqedonas ku mbizotërojnë simbolet e Zeusit (Jupiterit), që ishin ato të dhisë dhe të shkretimave.⁵⁴

Përsa u përket kolonive të tjera helene në afërsi të asaj të Lissos, një tjetër mund të ketë qenë edhe *Nymfeum*, i cili mund të ketë ekzistuar në breg të detit që në shek. V dhe, sipas Pierre Cabanes, duket se e ka pasur origjinën e tij si ngulmim helen, fillimisht si një pikë e vogël tregtare greke, që mund të ketë ekzistuar që në shek. IV para Kr.⁵⁵

Më vonë - pas Dionizit të Sirakuzës - këtu sunduan përsëri ilirët, gjë që përmendet qoftë në veprën e Hahn-it⁵⁶, qoftë nga Jireček⁵⁷, qoftë nga G. Valentini⁵⁸. Ilirët, mesa duket, ua zaptuan qytetin sirakusanëve dhe kjo mund të ketë ndodhur që në vitet e fundit të shek. IV para Kr.⁵⁹ Këta ilirë që ua morën qytetin sirakusanëve mund të kenë qenë nga fisi i taulantëve,

⁴⁹ J. Hahn, *Albanesische Studien*. [Erstes Heft] ..., f. 92.

⁵⁰ K. Jireček, “Skutari und sein Gebiet ...”, f. 123.

⁵¹ J. Hahn, *Albanesische Studien* [Erstes Heft], f. 93.

⁵² Frano Prendi & Koço Zheku, “La ville illyrienne de Lissus son origine et son système de fortifications”, në *L’Illyrie. La ville Illyrienne*, édition spéciale en français à l’occasion du Premier Colloque des Etudes Illyriennes. 15-21 septembre 1972, vol. II, Tirana: Universite de Tirana, 1972, f. 268.

⁵³ K. Jireček, “Skutari und sein Gebiet ...”, f. 123.

⁵⁴ G. Valentini, *Vepra I...*, f. 443; G. Valentini, *Vepra III...*, f. 233.

⁵⁵ P. Cabanes, *Historia e Adriatikut...*, f. 59.

⁵⁶ J. Hahn, *Albanesische Studien*. [Erstes Heft], f. 93.

⁵⁷ K. Jireček, “Skutari und sein Gebiet ...”, f. 123.

⁵⁸ G. Valentini, *Vepra III...*, f. 233.

⁵⁹ Selami Pulaha, “Vështrim mbi historinë e Lezhës”, në *Lissus*, Tiranë: Naim Frashëri, 1967, f. 88.

sepse pikërisht gjatë kësaj kohe kemi një afrim në drejtim të Lissosit të kufijve të mbretërisë së tyre nën Glaukun.⁶⁰

Qytetin ilirët e ndërtuan dhe e fortifikuan më tej me mure mbrojtëse rrethuese, “me pamje nga lugina e poshtme e lumit Drin dhe nga deti, a thua se ndërtuesit donin të mbroheshin nga pushtues që mund të vinin nga deti”⁶¹. Muret rrethuese vinin nga të dyja anët dhe arrinin deri në breg të lumit Drin. Pjesa e poshtme e qytetit lidhej me anën e jashtme nëpërmjet një porte me oborr të brendshëm.⁶²

Më vonë, ilirët të tjerë, që u përkisnin fiseve të ardianëve nën Agronin (250-231 para Kr.) i afrohen qytetit dhe e pushtojnë. Mendohet se qyteti e humbi autonominë e tij pikërisht duke u bërë pjesë e mbretërisë së Agronit.⁶³

Lisus gjatë luftërave iliro-romake

Lisus përmendet edhe në ngjarjet që ndodhën gjatë Luftës së Parë Iliro-Romake në vitet 229-228 para Kr., të cilën romakët e zhvilluan kundër princshës Teuta. Në atë kohë Lisus ishte nën sundimin e Teutës.⁶⁴ Nga kjo luftë Teuta doli e mundur dhe u detyrua të paguante haraç vjetor dhe të lëshonte edhe trojet që kishte pushtuar, përveç disa krahinave në jug të Lisusit, ku banonin antinët, ardianët dhe parthinët, të cilët ishin nën epërsinë e saj.⁶⁵

Një pikë tjetër e marrëveshjes së paqes që u bë me Teutën e mundur ishte edhe moslejimi i kalimit të më tepër se dy lembave tregtare* ilire të paarmatosura në jug të Lisusit, me qëllim që të siguroheshin rrugët detare ndërmjet Greqisë dhe Gadishullit Italik, si dhe të ndaloheshin aktivitetet ilire me Greqinë.⁶⁶ Moskalimi i vijës së Lisusit nënkupton që qyteti në atë

⁶⁰ Po aty.

⁶¹ P. Cabanes, *Historia e Adriatikut ...*, f. 59.

⁶² Po aty, f. 59.

⁶³ S. Pulaha, *Lezha - Vështrim historik-geografik ...*, f. 18-19; shih edhe S. Pulaha, “Vështrim mbi historinë e Lezhës...”, në *Lissus ...*, f. 88.

⁶⁴ Arthur Evans, *Ancient Illyria: An Archaeological Exploration*, edited by Bejtullah Destani, London / New York: I. B. Tauris 2006, f. 276.

⁶⁵ D. Vollmer, *Symploke: das Übergreifen der römischen...*, f. 54.

* *Lembus* = lloj anijeje e lehtë luftime që përdoren në Antikitet.

⁶⁶ D. Vollmer, *Symploke: das Übergreifen der römischen...*, f. 54; shih edhe: Danijel Dzino, *Illyricum in Roman Politics, 229 BC–AD 68*. Cambridge/New York [...]: Cambridge University Press 2010, f. 48.

kohë ishte akoma nën pushtetin e Teutës, të cilën romakët e kishin lejuar të qëndronte në pushtet si bashkëregjente me Pinin, djalin e vogël të mbretit ilir Agron, bashkëshortit të saj.⁶⁷ Pini në fakt nuk ishte i biri i Teutës, por i Tritetutës, gruas së parë të Agronit, e cila më pas ishte martuar me Dhimitrin e Farit.⁶⁸

Megjithatë pikat e marrëveshjes, mesa duket, nuk u respektuan nga ilirët, sepse gjatë kësaj kohe duhet të ketë pasur përsëri plaçkitje të krahinave në jug të Lisusit, gjë që shkaktoi pak kohë më pas edhe Luftën e Dytë Iliro-Romake (219 para Kr.).

Thyerja e marrëveshjes së vitit 228 ishte bërë në këtë rast nga Dhimitri i Farit, i cili e kishte shkelur vijën e Lisusit, për të cilën ishte vendosur në marrëveshje që të mos kalohej. Dhimitri i Farit e kishte kaluar këtë linjë me anije ushtarake dhe, ndër të tjera, kishte sulmuar territoret e Atintanëve, qytetet Epidamnos dhe Apolloni.⁶⁹ Përveç kësaj, rreth 50 lembe të flotës së tij e kishin kaluar jashtëzakonisht shumë vijën e Lisusit dhe ishin nisur për të sulmuar ishujt Kyklade në Egje.⁷⁰

Në fakt, siç u tha edhe më sipër, këtë marrëveshje romakët e kishin bërë me Teutën, por Dhimitri i Farit pas vdekjes së Teutës në vitin 219 konsiderohej nga romakët si pasardhës legjitim i saj* dhe si rrjedhojë çdo marrëveshje që ishte bërë me të ishte e vlefshme edhe me Dhimitrin.⁷¹ Menjëherë pas këtyre ngjarjeve në krye të shtetit të ardianëve erdhi Skerdilaidi, i cili në konfliktin romako-maqedonas, që tashmë kishte shpërthyer, mbante anën e Romës.⁷²

⁶⁷ D. Dzino, *Illyricum in Roman Politics ...*, f. 48.

⁶⁸ *The Cambridge Ancient History*, Second Edition, Volume VIII: Rom and the Mediteranian to 133 B.C., edited by A. E. Astin, F. W. Walbank F.B.A., M.W.Frederiksen, R. M. Ogilvie. Cambridge: University Press 1989, f. 91.

⁶⁹ D. Dzino, *Illyricum in Roman Politics ...*, f. 73.

⁷⁰ A. Evans, *Ancient Illyria ...*, f. 276; D. Dzino, *Illyricum in Roman Politics ...*, f. 51.

* Dhimitri i Farit vlente si pasardhës legjitim i Teutës, ngaqë pas vdekjes së saj më 219, ai kishte marrë përsipër kujdestarinë e Pinnes, të birit të Agronit, mbretit të ilirëve, dhe ishte martuar me të venë e tij Tritetutën. D. Vollmer, *Symploke: das Übergreifen der römischen...*, f. 73.

⁷¹ *Po aty*.

⁷² S. Pulaha, *Lezha - Vështrim historik-gjeografik ...*, f. 19.

Përsa i përket kësaj periudhe, pikërisht në vitin 228, në kohën e Luftës së Parë Iliro-Romake, sipas H. Cekës, kemi mbase prerjet e para të monedhave autonome të qytetit të Lisusit.⁷³

Pushtimi nga Filipi V i maqedonasve

Në vitin 213 para Krishtit, siç na tregon edhe Polibi, Lisus së bashku me Akrolisin që ndodhej sipër tij u pushtua nga Filipi V i Maqedonisë (Fig. 4.)⁷⁴, i cili arriti aty mbas dy ditësh marshim,⁷⁵ gjatë kohës kur po zhvillohej Lufta e Parë Maqedone-Romake. Filipi po mendohej të zgjeronte pushtimet e veta në Iliri, duke pushtuar qendra dhe territore të tjera ilire. Pikësynimi i tij kryesor ishte pushtimi i Apolonisë, e cila do t'i shërbente atij si bazë për ekspedita në Itali.⁷⁶ Romakët e kuptuan strategjinë e tij dhe dërguan një flotë në Apolloni, e cila e goditi ushtrinë e Filipit papritmas dhe i shkaktoi humbje.⁷⁷ Megjithatë, Filipi nuk u dekurajua. Ai e drejtoi ushtrinë e tij tek një qytet tjetër me port, në Lisus.

Zhvillimin e ngjarjeve të pushtimit të Lisusit nga Filipi V na e përshkruan Polibi dhe historianë të tjerë të kohërave më të vona, të cilët kanë si bazë tregimin e këtij autori antik. Sipas Polibit, Filipi ëndërronte prej kohësh që t'i shtinte në dorë Lisusin dhe Akrolisin.⁷⁸ Filipi i Maqedonisë kishte bërë në vitin 216 p. Kr. një armëpushim me kartagjenasit, ngaqë kishte ndërmend të pushtonte troje romake, duke filluar së pari në bregdetin ilir.

⁷³ H. Ceka, *Probleme të numismatikës ilire ...*, f. 95.

⁷⁴ Harta që tregon luftën ndërmjet Filipit V të Maqedonisë kundër ilirëve në Lisus, është marrë nga: Johannes, Kromayer & Georg Veith, *Schlachten-Atlas zur antiken Kriegsgeschichte*: 120 Karten auf 34 Tafeln; mit begleitendem Text (2. Lieferung, Römische Abteilung 2): Von Cannae bis Numantia. Leipzig: H. Wagner & E. Debes, 1922, Blatt (fletë) 10.

⁷⁵ J. Hahn, *Albanesische Studien*. [Erstes Heft] ..., f. 92-93.

⁷⁶ S. Pulaha, *Lezha - Vështrim historik-gjeografik ...*, f. 19.

⁷⁷ *Po aty*.

⁷⁸ Polybi, "Historiae", në *Ilirët dhe Iliria ...*, f. 61.



Fig. 4. Hartë që tregon luftën midis Filipit V të Maqedonisë dhe ilirëve në vitin 213 p. Kr.

Burimi: J. Kromayer/ G. Veith, *Schlachten-Atlas zur antiken Kriegsgeschichte*, Bl. 10.

Ilirët që gjatë kësaj kohe zotëronin Lissusin, ishin aleatë të romakëve, dhe mesa duket qyteti gëzonte në atë kohë autonomi.⁷⁹ Pas dy ditëve marshim, duke kaluar nëpër shtigjet e ngushta të lumit Ardaksanos (Mati

⁷⁹ S. Pulaha, “Vështrim mbi historinë e Lezhës ...”, në *Lissus*, f. 89.

i sotëm) ai i afrohet Lisusit dhe e vendos kampin e tij jo shumë larg, në një qytet kufitar të quajtur Bassania (Bërzana afër Rubikut).⁸⁰ Aty, ai vë re që rrethi i qytetit është i përforcuar mirë qoftë nga natyra, qoftë nga dora e njeriut; edhe Akrolisi që ishte pranë, kishte aq lartësi të madhe dhe ishte aq i fortë, saqë edhe me një vështrim të vetëm kuptohej menjëherë, se pushtimi i tij ishte i pamundur.⁸¹ Pas një dite pushimi ai dërgoi disa trupa të armatosur lehtë që të vendoseshin në vendin midis Lisusit dhe Akrolisit, pikërisht aty ku terreni formon një lakore në formë shale, me qëllim që të ngrinin një pusi.

Filipi nis kundër qytetit pjesën kryesore të ushtrisë. Në mëngjesin e ditës tjetër duke kaluar pa u diktuar në grykën e Manatisë dhe në grykën midis malit të Mërqisë e të Shelbuemit.⁸² Kështu, duke hyrë nga ana veriore, ata zunë pritë në vendin e pyllëzuar të lokalitetit që sot quhet Varosh. Mbrojtësit e Lisusit dolën nga qyteti dhe zunë vend në shpatin para mureve, ndërkohë që ushtria e Filipit ishte vendosur në luginë dhe nuk lëvizte. Disa trupa që ishin të armatosur lehtë u hodhën fillimisht në sulm, por u zbrapsën nga forcat ilire, të cilat i ndiqnin trupat e Filipit edhe në luginë.⁸³ Ndërkaq pjesa kryesore e ushtrisë së Filipit bëri sikur po tërhiqej duke marrë pas vetes qoftë mbrojtësit e qytetit, qoftë ata të Akrolisit, të cilët vërsulen poshtë duke e lënë të pambrojtur Akrolisin.⁸⁴ Ndërkaq hyjnë në veprim trupat e fshehura e të armatosura lehtë, të cilat ia presin rrugën mbrojtësve të Akrolisit. Edhe pjesa kryesore e ushtrisë maqedonase, e armatosur rëndë bëri përpara, dhe i detyroi ilirët që të futeshin sërish në qytet. Akrolisi pushtohet dhe një ditë më pas bie edhe qyteti Lisus.⁸⁵ Nga Lisus, Filipi V i Maqedonisë filloi të kërcënonte Dyrrahin e Apoloninë dhe po përgatitej për t'u hedhur në Itali.⁸⁶ Megjithatë, kjo gjendje nuk zgjati shumë kohë, pasi me përfundimin e Luftës Romake-Maqedonase dhe me Paqen e Tempes (197 p. Kr.), Filipi

⁸⁰ S. Pulaha, *Lezha - Vështrim historik-geografik ...*, f. 20.

⁸¹ Polybi, "Historiae", në *Ilirët dhe Iliria ...*, f. 62.

⁸² S. Pulaha, "Vështrim mbi historinë e Lezhës ...", në *Lissus...*, f. 89-90.

⁸³ Polybi, "Historiae", në *Ilirët dhe Iliria ...*, f. 62.

⁸⁴ Po aty, f. 62.

⁸⁵ Cammillo Praschniker, "III. Die Einnahme von Lissos durch Philipp V. von Makedonien 213 v. Chr.", në J. Kromayer & G. Veith, *Schlachten-Atlas zur antiken Kriegsgeschichte ...* f. 51-52; Polybi, "Historiae", në *Ilirët dhe Iliria ...*, f. 61.

⁸⁶ S. Pulaha, "Vështrim mbi historinë e Lezhës...", në *Lissus...*, f. 90.

V u detyrua që t'ua kthente Lisusin me tokat e tjera të pushtuara, shtetit të ardianëve, të cilët e kishin pasur qytetin më parë dhe kishin mbajtur anën e Romës.⁸⁷

Nën sundimin e mbretit ilir Gent

Nën ardianët Lisus qëndroi relativisht për një kohë të gjatë dhe fitoi gjallëri ekonomike sidomos nën sundimin e mbretit Gent (181-180 deri në vitin 167 para Kr.). Pasi kishin qenë më parë në Shkodër, dy ambasadorë të Perseut, Adeu maqedonas dhe iliri Pleurat erdhën e u takuan me Gentin brenda mureve të Lisusit, me qëllim që të lidhnin aleancë kundër armikut të përbashkët.⁸⁸ Bisedimet filluan në Lisus, në janar të vitit 169 dhe përfunduan në janarin e vitit tjetër 168,⁸⁹ Genti e theu aleancën me Romën, pikërisht në këtë qytet në vitin 168 para Kr. Genti mblodhi forcat e tij për të luftuar romakët.⁹⁰

Pra, romakët nga aleatë që kishin qenë më parë dhe që u kishin ndihmuar ardianëve që t'u rimerrnin qytetin maqedonasve me në krye Filipin V, ishin kthyer 30 vjet më vonë në armiq të përbashkët qoftë për ardianët qoftë për maqedonët. Perseu i Maqedonisë mundi ta bënte për vete mbretin ilir dhe ta përfshinte si aleat të tij në konfliktin që ai kishte me Romën.⁹¹ Lufta III Iliro-Romake që plasi edhe për shkak të kësaj aleance me maqedonasit çoi në humbjen e Gentit dhe si rrjedhim Shkodra dhe Lisusi (168 para. Kr.) ranë në duart e romakëve.⁹²

Genti dhe Perseu bashkë me familjet e tyre, me plaçkë e robër të shumtë lufte u dërguan në Romë dhe kështu morën fund dy shtetet e fuqishme të Ballkanit, duke u krijuar mundësi romakëve që të depërtonin

⁸⁷ Th. Ippen, *Skutari und die Nordalbanische ...*, f. 57.

⁸⁸ “*Hi transgressi iugum Scordi montis, per Illyrici solitudines, quas de industria populando Macedones fecerant, ne transitus faciles Dardanis in Illyricum aut Macedoniam essent, Scodram labore ingenti tandem peruenerunt. Lissi rex Gentius erat...*” Titus Livius. XLIII, 20. The Latin Library URL: <http://www.thelatinlibrary.com/livy/liv.43.shtml> (11. 11. 2017); shih edhe: S. Islami, *Historia e ilirëve...*, f. 129.

⁸⁹ S. Islami, *Historia e ilirëve...*, f. 129.

⁹⁰ A. Evans, *Ancient Illyria ...*, f. 276.

⁹¹ S. Pulaha, “Vështrim mbi historinë e Lezhës ...”, në *Lissus...*, f. 91.

⁹² Po aty.

lehtësisht me pushtimet e tyre nëpër krahinat e tjera të Ballkanit dhe të pellgut të Egjeut.⁹³

Nga kjo periudhë e sundimit të Gentit, në të cilën Lisusi ashtu si Shkodra ishte rezidenca princërore (provizore), kemi edhe monedha të këtij qyteti,⁹⁴ i cili së bashku me Shkodrën njihej edhe si vend, ku priteshin këto monedha.⁹⁵ Kjo është faza e dytë e prerjeve autonome të monedhave të qytetit dhe në faqet e këtyre monedhave ishte vënë portreti i Gentit që mbante në kokë një kapele të tipit “Kausia”, dhe në anën tjetër të tyre paraqitej një anije ilire me legjendën LISSI-TAN (ΛΙΣΣΙ–ΤΑΝ).⁹⁶ Në disa monedha të tjera pak më të mëvonshme, për të cilat supozohet se janë prerë rreth viteve 167-135 para Kr., vihet re edhe emri Ballaios (ΒΑΛΛΑΙΟΣ), i cili mund të ketë qenë ndonjë mbret ilir,⁹⁷ për të cilin hëpërhë nuk kemi të dhëna.

Nën sundimin romak

Siç u tha më sipër, Lisusi ra në duart e romakëve pikërisht në vitin 168 para. Kr.⁹⁸ Romakët e ndanë shtetin e ardianëve në tri njësi administrative: duke e nisur nga territoret e Lisusit njësia e parë shtrihej midis kufijve jugorë të labeatëve dhe lumit Mat dhe kishte si qendër Lisusin, njësia e dytë shtrihej përreth Shkodrës me qendër po këtë qytet dhe këtu jetonin kryesisht fisi i labeatëve, kurse njësia e tretë shtrihej nga lumi Naronë (Neretva) deri në veri të Shkodrës.⁹⁹

⁹³ S. Islami, *Historia e ilirëve...*, f. 133.

⁹⁴ A. Evans, *Ancient Illyria ...*, f. 281.

⁹⁵ Ante Škegro, “Bergbau der römischen Provinz Dalmatien”, në *Godišnjak*, Centra za balkanološka ispitivanja, Akademija nauka i umjetnosti Bosne i Hercegovine, knj. XXXI/29, Sarajevo: 2000, f. 67.

⁹⁶ K. Zheku, *Lisi në shekuj...*, f. 50; shih edhe: H. Ceka, *Probleme të Numismatikës ilire...*, f. 94. Në të dhënat e tij Ceka nuk thotë që portreti i burrit me kapele ilire, ishte vetë mbreti Gent.

⁹⁷ K. Zheku, *Lisi në shekuj...*, f. 49.

⁹⁸ *Illyrici Sacri. Tomus Septimus, Ecclesia Diocletiana, Antibarensis, Dyrhachiensis et Sirmiensis, cum eorum suffraganeis*. Auctore Daniele Farlato, Presbytero Societatis Jesu, et Jacobo Coletto olim ejusdem Societatis alumno. Venetiis, MDCCCXVII. Aput Sebastianum Coleti. Superiorem permissu ac privilegio. (Botim i dytë, Prishtinë: Arbi 2004) (më tej: D. Farlati, *Illyricum Sacrum VII ...*, f. 384.

⁹⁹ S. Pulaha, “Vështrim mbi historinë e Lezhës ...”, në *Lissus ...*, f. 91.

Lisus ishte njëkohësisht edhe qyteti më jugor i provincës Dalmatia dhe pikë nisjeje për rrugët e mëdha për në Salonë, Naissus (Nish) dhe Dyrrachion.¹⁰⁰ Së bashku me këto qytete, ku përmenden edhe Shkodra, Kolcinium (Ulqini), Butua (Budva) Plini radhit edhe Lisusin si *Oppidum civium Romanum*.¹⁰¹

Në pjesën e poshtme të qytetit (në brendësi të rrethimit) janë bërë restaurime edhe në kohën e Cezarit dhe aty është e habitshme që nuk gjenden gjurmë të ndërtesave apo të ndonjë godine publike, dhe kjo të jep përshtypjen, sikur Lisus gjatë atyre kohërave nuk ka qenë një qytet i mirëfilltë, por një vendstrehim i fortifikuar, ku futej popullsia e zonave edhe e fshatrave përreth në kohë rreziqesh.¹⁰² Gjatë kësaj periudhe romake, sidomos nën sundimin e Cezarit muret rrethuese të qytetit, të cilat i përkisnin periudhës helene, u zgjeruan edhe më tej¹⁰³. Në këtë periudhë qyteti merr emron latin: *Lissum*.¹⁰⁴

Përsa i përket lumit Drin që kalonte përpara qytetit, nuk ka pasur gjithmonë të njëjtën prurje uji, ngaqë ka dy degëzime aktive. Njëra degë e tij vazhdon në drejtim të perëndimit dhe bashkohet me Bunën, kurse dega tjetër vazhdon drejt jugut, kalon përpara Lisusit dhe derdhet në Shëngjin, ose në Nymphem, siç quhej ky lokalitet në lashtësi.¹⁰⁵ Nga Antikiteti deri në shek. XV, Drini ishte i lidhur me Bunën. Si rrjedhim sasia e prurjeve në degën e Lisusit ishte zvogëluar me dy të tretat e prurjes së përgjithshme të Drinit.¹⁰⁶

¹⁰⁰ K. Jireček, "Skutari und sein Gebiet ...", f. 123.

¹⁰¹ "a Narone amne C p. abest Epidaurum colonia. ab Epidauo sunt oppida civium Romanorum Rhizinium, Acruium, Butuanum, Olcinium, quod antea Colchinium dictum est, a Colchis conditum, amnis Drino superque eum oppidum civium Romanorum Scodra ab mari XVIII, praeterea multorum Graeciae oppidorum deficiens memoria nec non et civitatum validarum: eo namque tractu fuere. Labeatae, Senedi, Rudini, Sasaei, Grabaei; proprieque dicti Illyri et Taulanti et Pyraei retinent nomen. in ora Nymphaeum promunturium. Lissum oppidum civium Romanorum ab Epidauo C p."

Plinii, *Naturalis Historiae*, Liber III, 144. The Latin Library. URL: <http://www.thelatinlibrary.com/pliny.nh3.html> (11.11.2017)

¹⁰² P. Cabanes, *Historia e Adriatikut...*, f. 59.

¹⁰³ M. Šufflay, *Städte und Burgen Albaniens...*, f. 9-10.

¹⁰⁴ *Po aty*, f. 10.

¹⁰⁵ *Po aty*.

¹⁰⁶ *Po aty*.

Porti i Shën Gjinit është i përmendur qysh në periudhën romake dhe quhej “*tutissimus portus Nymfeum*” i lashtësisë, që sipas Julius Cezarit (tek *bello civili*) ndodhej 3 milje romake (4, 5 km) nga Lisus,¹⁰⁷ dhe gjatë periudhës romake duhet të ketë pasur lidhje të mira me qytetet e Gadishullit Italik, sidomos me qytetet romake.

Në Lisus, Cesari ka përjetuar edhe një ngjarje, të cilën e ka shkruar në veprën e tij “Mbi Luftën Civile” (Librat III dhe V) (*De Bello Civili*). Mbi këtë ngjarje, për të cilën po hapim një parantezë më poshtë, do t’i referohemi Theodor Ippenit,¹⁰⁸ por edhe tekstit origjinal të Cesarit tek *De Bello Civili, libri III*,¹⁰⁹ të cilin po e japim në referencë si burim origjinal.

¹⁰⁷ K. Jireček, “Skutari und sein Gebiet ...”, f. 121; M. Šufflay, *Städte und Burgen Albaniens...*, f. 10.

¹⁰⁸ Th. Ippen, *Skutari und die Nordalbanische ...*, f. 58-59.

¹⁰⁹ “[25] *Multi iam menses erant et hiems praecipitaverat, neque Brundisio naves legionesque ad Caesarem veniebant. Ac nonnullae eius rei praetermissae occasiones Caesari videbantur, quod certi saepe flaverant venti, quibus necessario committendum existimabat. Quantoque eius amplius processerat temporis, tanto erant alacriores ad custodias, qui classibus praeerant, maioremque fiduciam prohibendi habebant, et crebris Pompei litteris castigabantur, quoniam primo venientem Caesarem non prohibuissent, ut reliquos eius exercitus impedirent, duriusque cotidie tempus ad transportandum lenioribus ventis exspectabant. Quibus rebus permotus Caesar Brundisium ad suos severius scripsit, nacti idoneum ventum ne occasionem navigandi dimitterent, sive ad litora Apolloniatium [sive ad Labeatium] cursum dirigere atque eo naves eicere possent. Haec a custodiis classium loca maxime vacabant, quod se longius a portibus committere non audebant.*

[26] *Illi adhibita audacia et virtute administrantibus M. Antonio et Fufio Caleno, multum ipsis militibus hortantibus neque ullum periculum pro salute Caesaris recusantibus nacti austrum naves solvunt atque altero die Apolloniam praetervehunt. Qui cum essent ex continenti visi, Coponius, qui Dyrrachii classi Rhodiae praeerat, naves ex portu educit, et cum iam nostris remissiore vento appropinquasset, idem auster increbuit nostrisque praesidio fuit. Neque vero ille ob eam causam conatu desistebat, sed labore et perseverantia nautarum etiam vim tempestatis superari posse sperabat praetervectosque Dyrrachium magna vi venti nihilo secius sequebatur. Nostris usi fortunae beneficio tamen impetum classis timebant, si forte ventus remisisset. Nacti portum, qui appellatur Nymphaeum, ultra Lissum milia passuum III, eo naves introduxerunt (qui portus ab Africo tegebatur, ab austro non erat tutus) leviusque tempestatis quam classis periculum aestimaverunt. Quo simulatque introitum est, incredibili felicitate auster, qui per biduum flaverat, in Africum se vertit.*

Meqenëse Cezar ishte i zënë me luftën e tij në Gali dhe me rivalin e tij Pompeun, kjo gjë u dha rast ilirëve që të bënin kryengritje ndërsa pirustët që banonin në atë kohë në krahinën e Mirditës së Sotme sulmuan në vitin 54 hinterlandin e Lisusit. Cezari u detyrua që të kthehej në Adriatik me qëllim që të nënshtropte kryengritësit. Për shkak të luftërave

[27] *Hic subitam commutationem fortunae videre licuit. Qui modo sibi timuerant, hos tutissimus portus recipiebat; qui nostris navibus periculum intulerant, de suo timere cogebantur. Itaque tempore commutato tempestas et nostros texit et naves Rhodias afflixit, ita ut ad unam omnes, constratae numero XVI, eliderentur et naufragio interirent, et ex magno remigum propugnatorumque numero pars ad scopulos allisa interficeretur, pars ab nostris detraheretur; quos omnes conservatos Caesar domum dimisit.*

[28] *Nostrae naves duae tardius cursu confecto in noctem coniectae, cum ignorarent, quem locum reliquae cepissent, contra Lissum in ancoris constituerunt. Has scaphis minoribusque navigiis compluribus immissis Otacilius Crassus, qui Lissi praeerat, expugnare parabat; simul de deditione eorum agebat et incolumitatem deditis pollicebatur. Harum altera navis CCXX e legione tironum sustulerat, altera ex veterana paulo minus CC. Hic cognosci licuit, quantum esset hominibus praesidii in animi firmitudine. Tirones enim multitudine navium perterriti et salo nauseaque confecti iureiurando accepto, nihil eis nocituros hostes, se Otacilio dederunt; qui omnes ad eum producti contra religionem iurisiurandi in eius conspectu crudelissime interficiuntur. At veteranae legionis milites, item conflictati et tempestatis et sentinae vitii, neque ex pristina virtute remittendum aliquid putaverunt, et tractandis condicionibus et simulatione deditionis extracto primo noctis tempore gubernatorem in terram navem eicere cogunt, ipsi idoneum locum nacti reliquam noctis partem ibi confecerunt et luce prima missis ad eos ab Otacilio equitibus, qui eam partem orae maritimae asservabant, circiter CCCC, quique eos armati ex praesidio secuti sunt, se defenderunt et nonnullis eorum interfectis incolumes se ad nostros receperunt.*

[29] *Quo facto conventus civium Romanorum, qui Lissum obtinebant, quod oppidum eis antea Caesar attribuerat muniendumque curaverat, Antonium recepit omnibusque rebus iuvit. Otacilius sibi timens ex oppido fugit et ad Pompeium pervenit. Expositis omnibus copiis Antonius, quarum erat summa veteranarum trium legionum uniusque tironum et equitum DCCC, plerasque naves in Italiam remittit ad reliquos milites equitesque transportandos, pontones, quod est genus navium Gallicarum, Lissi relinquit, hoc consilio, ut si forte Pompeius vacuam existimans Italiam eo traiecisset exercitum, quae opinio erat edita in vulgus, aliquam Caesar ad insequendum facultatem haberet, nuntiosque ad eum celeriter mittit, quibus regionibus exercitum exposuisset et quid militum transvexisset.” Caesar, De Bello Civili, libri III, The Latin Library. URL: në <http://www.thelatinlibrary.com/caesar/bc3.shtml> (19.11.2017)*

që kishte pasur me rivalin e tij Pompeus, ai kishte mundur të sillte nga Apulia në “Shqipërinë e Mesme” vetëm një pjesë të ushtrisë së tij, duke e lënë kështu pjesën tjetër në Brindisium.¹¹⁰

Kampin e kishte vendosur në lumin Apsus (Seman), por ngaqë situata aty sa vinte e rëndohej, i dha urdhër Mark Antonit që të kalonte Adriatikun dhe të takohej me të në afërsi të Apolonisë, në grykëderdhjen e lumit Aous (Vjosë). Këto lëvizje nëpër det po bëheshin në një kohë të papërshtatshme, ngaqë ishte dimër. Urdhri u zbatua, porse flota armike e Rodosit dhe era e pafavorshme jugore në det e detyruan Mark Antonin që t’i drejtohej portit të Nymfeum më në veri.¹¹¹ 16 anije të Pompeut të cilat po ndiqnin Mark Antonin, nuk mundën që të futeshin në port pasi era e ndërroi drejtimin dhe dështoi hyrjen e tyre. Dy anije të Mark Antonit gabuan rrugën dhe iu drejtuan Lisusit.¹¹²

Ekui pazhi i njëres prej flotës u shpartallua nga një roje bregdetare pompejane që mbante qytetin të pushtuar, kurse veteranët e anijes tjetër arritën që të depërtonin për në Nymfeum. Të nesërmen Lisus u deklarua në anën e Cezarit, detyroi komandantin armik pompeas që të arratisej dhe pranoi Mark Antonin brenda mureve, duke e mbështetur atë me çdo lloj mënyre.¹¹³ Mark Antoni i dërgoi Cezarit lajmëtarë që t’i tregonin atij vendin e zbarkimit, me qëllim që ushtria të bashkohej. Lufta kundër Pompeusit u bë në Dyrachium gjatë vitit 48 para Kr. Lisus gjatë kësaj lufte furnizonte Cezarin me drithë dhe pas disfatës dhe ikjes së tij në korrik të atij viti, në qytet mbeti si garnizon një kohortë.¹¹⁴ E mbyllim këtu parantezën në lidhje me luftën midis Cezarit dhe Pompeut, për të vazhduar më tej me rrjedhën e ngjarjeve të tjera.

Gjatë periudhës së Antikitit, sidomos të asaj romake, Lisus ishte kreu apo stacioni i parë i një rruge të rëndësishme tregtare që shkonte përmes vendit të pasur me argjend të pirustëve dhe Moezisë së Sipërme.¹¹⁵ Kjo rrugë u bë shumë e rëndësishme dhe u përmirësua shumë sidomos në periudhën e perandorit August.¹¹⁶ Përveç kësaj Lisus ishte i

¹¹⁰ Caesar, *De Bello Civili* ..., libri III, 26-29; Th. Ippen, *Skutari und die Nordalbanische* ..., f. 58.

¹¹¹ Caesar, *De Bello Civili* ..., libri III, 26.

¹¹² *Po aty*, 27.

¹¹³ *Po aty*, 28. Th. Ippen, *Skutari und die Nordalbanische* ..., f. 59.

¹¹⁴ Th. Ippen, *Skutari und die Nordalbanische* ..., f. 59.

¹¹⁵ M. Šufflay, *Städte und Burgen Albaniens*..., f. 12.

¹¹⁶ *Po aty*.

lidhur nëpërmjet një rruge të ndërtuar mirë edhe me qytetet e tjetra, Shkodrën (Scodra), Salonën në veri dhe me Dyrhahionin në jug.¹¹⁷ Lissus gjatë kësaj periudhe, ose ishte në aleancë me Romën ose ishte tributar ndaj saj.¹¹⁸ Njëkohësisht aty kishte filluar të krijohet edhe një koloni romake.

Përsa i përket kolonisë romake brenda qytetit, gjejmë një korporatë të organizuar njerëzish të të gjitha profesioneve që njihet nën terminologjinë “Kuvend i qytetarëve romanë” (*conventus civium Romanorum*)¹¹⁹, që ishte pak a shumë një klasë patricësh, gjë që është shumë e rrallë për qytetet në të cilat funksiononte ligji romak.¹²⁰ Kjo lloj korporate ekzistonte në ato qytete që po kalonin nga sistemi juridik grek në sistemin juridik romak, sistem që Lissus, sipas Shufflait, e mori në kohën e sundimit të perandorit Oktavian.¹²¹

Megjithatë edhe më përpara, në kohën e Jul Cezarit kishte një organizim të tillë, por këtu bëhet fjalë për *conventus*¹²² përse i përket burimeve, dhe jo përse i përket administrimit të qytetit.¹²³ Lissus pati një *conventus* pikërisht që në kohën e Jul Cezarit, pasi i kishte kapërcyer problemet që pati me pirustët në vitin 54 para Kr.¹²⁴ Në mesin e shekullit I para Kr. dëshmohen edhe *conventus* tregtarësh italikë në qytetet Lis, Naronë, Salonë dhe në Epidaurum.¹²⁵ Gjatë kësaj periudhe Lissus bëhet një pikë e rëndësishme portuale dhe qarkullimi.¹²⁶ Kjo shoqëri romane në Lis ishte formuar nga tregtarë që kishin ardhur dhe ishin vendosur aty kryesisht pas rënies së qytetit në duart e romakëve.

Përveç ekzistencës së një “Kuvendi të qytetarëve romanë” (*conventus civium Romanorum*), Lissus konsiderohej edhe si një

¹¹⁷ *Po aty*.

¹¹⁸ D. Farlati, *Illyricum Sacrum VII ...*, f. 384.

¹¹⁹ Caesar, *De Bello Civili ...*, libri III, 29.

¹²⁰ M. Šufflay, *Städte und Burgen Albaniens...*, f. 13.

¹²¹ *Po aty*, f. 14.

¹²² Caesar, *De Bello Civili ...*, libri III, 29.

¹²³ D. Dzino, *Illyricum in Roman Politics ...*, f. 89.

¹²⁴ *Po aty*; shih edhe S. Pulaha, “Vështrim mbi historinë e Lezhës...”, në *Lissus ...*, f. 91.

¹²⁵ D. Dzino, *Illyricum in Roman Politics ...*, f. 89.

¹²⁶ *Albania Sacra. Geistliche Visitationsberichte aus Albanien 1: Diözese Alessio*. Hrsg. u. bearb. von Peter Bartl. Wiesbaden: Harrowitz 2007, f. 13.



Fig. 5. Në rreth Skodra dhe Lissus në hartën Tabula Peutingeriana, shek. III-IV pas. Kr.

Burimi: Wien, Österreichische Nationalbibliothek (ÖNB): Bildarchiv, Cod. 324. Marrë nga: Euroatlas. URL: www.euroatlas.net

“*oppidum civium romanorum*”¹²⁷ (qytet i qytetarëve romakë), gjë që dëshmon latinizimin e avancuar të qytetit qysh prej kohës së Livit, dhe, sipas Valentinit, qyteti mbeti me popullsi tipike latine deri në fund të shek. XV.¹²⁸ Kategorizimin si “qytet i qytetarëve romakë” (*oppidum civium romanorum*), Lissus duhet ta ketë marrë zyrtarisht në fund të shek. I para. Kr., në kohën e perandorit August. Më pas ai mori organizim dhe natyrë akoma më shumë romake.¹²⁹

Gjatë kësaj kohe këshilli i qytetit (*ordo decurionum*) kishte pushtetin më të lartë dhe

vendoste mbi çështjet me rëndësi për qytetin, ndërsa pushteti ekzekutiv ishte në dorën e një kolegji të përbërë prej dy magistrash (*diumviri quinquenalis*).¹³⁰ Në rang të tretë për nga rëndësia vinte *edili (aedil)* i cili merrej me ndërtimet publike, furnizimin e qytetit, dhe kuestori (questor) që mbikëqyrte arkën e shtetit.¹³¹ Megjithatë, ky karakterizim (*oppidum civium romanorum*) duhet të ketë qenë më tepër rrjedhojë e të së drejtës së qytetarisë romake që duhet ta kenë pasur banorët e Lissusit.¹³²

¹²⁷ “*Lissum oppidum civium Romanorum ab Epidauro C p.*” Plinii, *Naturalis Historiae* ..., Liber III, 144.

¹²⁸ G. Valentini, *Vepra I...*, f. 444; G. Valentini, *Vepra III...*, f. 234.

¹²⁹ S. Pulaha, “Vështrim mbi historinë e Lezhës...”, në *Lissus* ..., f. 92.

¹³⁰ Po aty, f. 93.

¹³¹ Po aty.

¹³² Gëzim Hoxha, *Die antiken Quellen zu Lissus in Illyrien* [material i pabotuar, vënë në dispozicion nga vetë autori G. Hoxha], f. 9.

Në gjysmën e dytë të shek. I pas Kr., Lissus bëhet qendër e krahinës së banuar nga pirustët që i përkisnin lidhjes farefisnore ilire-panonike, dhe që kishin për prijës Baton.¹³³ Pikërisht në drejtimin e tij pirustët u njohën për rezistencën e madhe që u bënë ushtrive romake (*Bellum Batonianum*) në fazën e fundit dhe si rrjedhim u dënuan nga romakët me punë të detyruar kolektive nëpër miniera (*ad metalla*).¹³⁴

Qyteti mbeti deri në fund të Perandorisë Romake një pikë kontrolli të qarkullimit të Gjirit të Drinit si dhe të portit për udhëtimet navale ilire. Ajo ishte edhe një nyjë lidhëse direkte me Shkodrën, Dyrrahiumin si dhe me provincat Dardani e Mysi, dhe me krahinat e Danubit, nëpërmjet luginës së Drinit.¹³⁵ Përveç Durrësit dhe Shkodrës etj, Lissus gjendet e shënuar edhe në hartën e lashtë të shek. III-IV pas Krishtit *Tabula Peutingeriana*, pikërisht përgjatë rrugës Durrës Salonë (fig. 5).¹³⁶

Në periudhën e perandorit Diokletian (284-305 pas. Kr.) qyteti bënte pjesë në provincën Praevalit dhe u përfshi në proceset transformuese të Antikitetit të Vonë,¹³⁷ dhe e ruajti statusin *municipium* deri në kohën e reformave që bëri perandori Diokletian.¹³⁸ Më vonë, sidomos gjatë shek. IV-V qyteti pëson edhe një zvogëlim të sipërfaqes së tij, nga ç'kishte qenë gjatë periudhave greko-romake.¹³⁹ Me ndarjen e Perandorisë Romake, Lezha u bë pjesë e Bizantit dhe u përfshi në Temën Dyrrahion.¹⁴⁰ Nga kjo periudhë nuk kemi të dhëna në lidhje me të, pasi menjëherë fillojnë dyndjet e popujve.

Shkatërrimi i Lissusit nga dyndjet barbare

Deri në shek. V-VI, duke u bazuar në të dhënat arkeologjike Lissus na paraqitet si një qytet me potencial të rëndësishëm ekonomik dhe zejtar, në të cilin kishte një qarkullim mjaft të dendur monetar, me prodhim lokal zejtar dhe me veprimtari ndërtuese ende aktive.¹⁴¹ Gjatë kësaj kohe

¹³³ K. Zheku, *Lisi në shekuj ...*, f. 19.

¹³⁴ A. Škegro, "Bergbau der römischen ...", në *Godišnjak XXXI/29 ...*, f. 71.

¹³⁵ G. Hoxha, *Die antiken Quellen ...*, f. 9.

¹³⁶ *Po aty*, f. 10.

¹³⁷ *Po aty*.

¹³⁸ G. Hoxha, "Die Transformationsprozesse in der Stadt Lissus ...", në *Proceedings of the International Congress ...*, f. 511.

¹³⁹ *Po aty*.

¹⁴⁰ *Albania Sacra I ...*, f. 13.

¹⁴¹ F. Prendi, "Vazhdimësia etno-kulturore ...", në *Lis 6 ...*, f. 8

Lisus ishte përveçse një qendër e rëndësishme, edhe një seli peshkopate. Në “Listën e Hieroklit” në shek. VI ai figuron si një ndër tre qytetet kryesore të provincës së Prevalit me kryeqendër Shkodrën.¹⁴²

Me të ashtuquajturën “Dyndje të popujve” situata ndryshon dhe qyteti mori një goditje të rëndë. Mesa duket, në vitin 592, gjatë kohës së kësaj dyndjeje Lisus sulmohet nga barbarët, dhe mbahet për një kohë të gjatë e pushtuar (*Lissus ab hostibus teneatur*)¹⁴³. Kjo e dhënë na vjen nga një dokument kishtar, në të cilin thuhet se papa Gregori I ngarkon me detyrën e kryepfritit në Kishën e Skillaçit (*ecclesiae Scyllacinae*) (në afërsi të Katanzaros), Gjonin, ipeshkvin e arratisur lezhjan (lissitan), meqë Lezha mbahej e pushtuar nga armiqtë.¹⁴⁴

Pra, Papa e pranon me dashamirësi Gjonin, por me kusht që kur qyteti të rikthehej në lirinë e tij të mëparshme, edhe ipeshkvi Gjini të rikthehej tek grigja e tij.¹⁴⁵ Këta armiq duhet të kenë qenë pa dyshim sllavë, të cilët depërtojnë në vitet 548-550 deri në Durrës.¹⁴⁶ Ata e dëmtuan rëndë qytetin e Lisusit, siç kishin bërë edhe me provinca të tjera të Ilirisë duke u vërsulur me tërbim dhe duke e vendosur atë nën zgjedhën e tyre. Si rrjedhojë, ipeshkvi i qytetit arratiset dhe shkon në Romë.¹⁴⁷ Prej tyre u shkatërruan edhe qytete të tjera bregdetare, si përshebull Salona dhe Epidaurum.¹⁴⁸

Dokumenti kishtar që cituam më sipër ka një vlerë të madhe, sepse është më i hershmi që dëshmon për ekzistencën e ipeshkvisë dhe dioqezës së Lisusit. Megjithatë, krishterimi duhet të ketë hyrë në Lezhë në kohëra më të hershme, kjo për vetë faktin se ky qytet ishte portual dhe

¹⁴² Po aty.

¹⁴³ *Acta et Diplomata res Albaniae Mediae Aetatis illustrantia*. Collegerunt et digesserunt Dr. Ludovigus de Thallóczy, Dr. Constantinus Jireček ed Dr. Emilianus de Sufflay. Volumen I (Annos 344-1343 tabelamque geographicam continens) Vindobonae MXMXVIII. Typis Adophi Holzhausen (më tej: AAlb. I), nr. 40.

¹⁴⁴ “592, mense iulio. Gregorius I. papa Johannem, expulsus episcopum Lissitanum, vacuae ecclesiae Scyllacinae, dum Lissus ab hostibus teneatur, praeesse iubet cardinalem sacerdotem”. AAlb. I, nr. 40.

¹⁴⁵ D. Farlati, *Illyricum Sacrum VII ...*, f. 386.

¹⁴⁶ “Sub hostibus haud dubie Slavi intelliguntur, qui iam a. 548 usque Eoidamnum (Dyrrhachium) progressi a 550 ...”. AAlb. I, nr. 40.

¹⁴⁷ “Cum Lissus a barbaris, fortasse, Slcavis, qui tum per illyrici provinciali imune grassabantur, in miserrimam vastitatem ac servitutem fuisset aducta ...”. D. Farlati, *Illyricum Sacrum VII ...*, f. 386.

¹⁴⁸ AAlb. I, nr. 40.

qendër qarkullimi. Farlati për dioqezën e Lisusit nuk përmend një datë më të hershme nga data 592, por thotë që “zanafilla e kishës së Lisusit, edhe pse është e panjohur, mund t’i referohet kohës, kur në Durrës depërtoi besimi i krishterë dhe i gjithë Epiri filloi të ndriçohet hyjnisht nga drita e Ungjillit.”¹⁴⁹

Pushtimi sllav sipas F. Prendit duket se zgjati së paku deri në fillim të shek. VII,¹⁵⁰ duke i shkaktuar qytetit humbjen e shkëlqimit të tij, të rëndësisë dhe të dendësisë që kishte pasur në Antikitet.

* * *

Këto ishin disa të dhëna për Lezhën në Antikitet, të cilat i paraprijnë një artikulli tjetër në lidhje me historinë e këtij qyteti gjatë Mesjetës artikull që do të botohet më vonë.

S u m m a r y

LISSUS DURING THE PERIOD OF THE ANTIQUITY

The article deals with the history of the city of Lissus (today Lezha) from the origins to the end of Antiquity. So at the center of this study is the period of Antiquity, during which the city had its ups and downs. The article has seven sections, which consist of a specific period of principal events of this city. The introductory chapter gives an overview of the primary sources and studies for this city. Apart from the text, the article has some views and maps that have their relevance in this study.

¹⁴⁹ “*Ecclesiae Alexiensis initia, quamvis ignota ad idem fere tempus referri possunt, quo Durrhachium Christiana religio invecta est, & Evangelii luce tota Epirus divinitus coepit illustrari*”, D. Farlati, *Illyricum Sacrum VII...*, f. 385.

¹⁵⁰ F. Prendi, “Vazhdimësia etno-kulturore ...”, në *Lis 6 ...*, f. 8.

